

S H E N I M E T S H P J E G U E S E

Sqarim:

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2 i permiresuar
Plotesimi i te dhenave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarde te
percaktuara ne SKK 2 te permiresuar. Rradha e dhenies se spjegimeve duhet te jetë :

- a) Informacion i përgjithsëm dhe politikat kontabël
- b) Shënimet qe shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Shënie të tjera shpjeguese

A I Informacion i përgjithshëm

- 1 Kuadri ligjor: Ligji Nr. 25/2018 date 10.05.2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- 2 Kuadri kontabel i aplikuar : Stndartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi.(SKK 2)
- 3 Baza e pergatitjes se PF : Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara.(SSK 1)
- 4 Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdonura per hartimin e P.F. : (SKK 1)
 - a) NJESIA EKONOMIKE RAPORTUSE ka mbajtur ne llogarite e saj aktivet,pasivet dhe transaksionet ekonomike te veta.
 - b) VIJIMESIA e veprimtarise ekonomike te njesise sone raportuse eshte e siguruar duke mos pasur ne plan ose nevoje nderprerjen e aktivitetit te saj.
 - c) KOMPENSIM midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka , ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet qe lejohen nga SKK.
 - d) KUPTUSHMERIA e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e pote per te qene te qarta dhe te kuptushme per perdonues te jashtem qe kane njohuri te per gjitheshme te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
 - e) MATERIALITETI eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zera materiale.
 - f) BESUSHMERIA per hartimin e Pasqyrave Financiare eshte e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e me poshteme :
 - Parimin e paraqitjes me besnikeri
 - Parimin e perparese se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
 - Parimin e paaneshmerise pa asnje influencim te qellimshem
 - Parimin e maturise pa optimizem te teperuar,pa nen e mbivleresim te qellimshem
 - Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF.
 - Parimin e qendrushmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat kontabel
 - Parimin e krahasushmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

A II Politikat kontabël

Per percaktimin e kostos se inventareve eshte zgjedhur metoda "FIFO" (hyrje e pare , dalje e pare.(SKK 4)

Vleresimi fillestar i nje elementi te AAM qe ploteson kriteret per njohje si aktiv ne bilanc eshte vleresuar me kosto. (SKK 5; 11)

Per prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga nje hua,kostot e huamarries (dhe interesat) eshte metoda e kapitalizimit ne koston e aktivit per periudhen e investimit.(SKK 5)

Per vleresimi i mepaseshem i AAM eshte zgjedhur modeli i kostos duke i paraqitur ne bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar. (SKK 5)

Per llogaritjen e amortizimit te AAM (SKK 5) njesia jone ekonomike ka percaktuar si metode te amortizimit te ndertesave metoden lineare dhe per AAM te tjera metoden e amortizimit mbi bazen e vlefte se mbetur ndersa normat e amortizimit jane perdonur te njellojta me ato te sistemit fiskal ne fuqi dhe konkretisht :

- Per ndertesat me 5 % te vlefte se mbetur
- Kompjutera e sisteme informacioni me 25 % te vlefte se mbetur
- Te gjitha AAM te tjera me 20 % te vlefte se mbetur

Per llogaritjen e amortizimit te AAJM (SKK 5) njesia ekonomike raportuese ka percaktuar si metode te amortizimit metoden lineare me normen e amortizimit me 15 % ne vit.

SHENIME SHPJEGUESE; Per periudhen 01 Janar deri me 31 Dhjetor 2023.

Ne kete aneks paraqiten informacionet shpjeguese ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare te njesise ekonomike NONA sh.p.k.

Njesia ekonomike NONA sh.p.k e krijuar me date 04.07.2018, ushtron aktivitetin e saj ne fushen bar kafe, restoran, prodhim ushqimor, ofrimi i sherbimeve te konsulences ne fushen e rmenaxhirnit te shoqerise, marketing, ligjore dhe logistike dhe dhenie me qera ambjenti, ne qytetin e Tiranes, me adresë Qendra Tregtare TEG, perbri parkimit ne oborr, Rruga Nacionale Tirane-Elbasan, kat I, zyra I.

Per periudhen 01 Janar 2023 deri me 31 Dhjetor 2023 jane pergatitur dhe paraqitur paketa e pote e pasqyrave financiare, te cilat jepin pamjen te vertete dhe te drejte te pozicionit financiare, performances financiare dhe fluksit te parase gjate kesaj periudhe.

Pergatitja dhe paraqitja e tyre, e cila eshte perjegjesi e Drejtimit te subjektit, eshte realizuar mbeshtetur ne Ligjin nr 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit (KKK). Gjuha e perdonur eshte gjuha shqipe. Monedha e perdonur eshte monedha Leke. Rrumbullakime te vlerave nuk ka. Ngjarjet dhe trasaksionet jane evidentuar gjate gjithe periudhes ushtrimore ne perputhje me SKK nr 1 Kuadri i pergjithshem per pergatitjen e pasqyrave financiare dhe SKK nr 2 Paraqitja e pasqyrave financiare si dhe cdo standard tjeter kombetar ne perputhje me natyren e ngjarjeve apo transaksioneve te cilat ne menyre te hollesishme do te jepen ne vijim te informacioneve shpjeguese.

❖ Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren BILANC.

Paraqitja e kesaj pasqyre eshte mbeshtur ne paketen e pote te standardeve te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit. Ne vijim do te jepen informacionet shpjeguese per zerat perberes te saj.

I. Informacione Shpjeguese per AKTIVET.

Totali i aktiveve te paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **907,727,054 leke** detajimi nepermjet informacioneve shpjeguese i te ciles paraqitet si vijon;

✚ Informacione shpjeguese te AKTIVE AFATSHKURTRA

Aktiveve afatshkurtra jane paraqitur ne vleren **203,536,063 leke** te cilat jane te perbera nga;

1. Aktive monetare 9,912 leke. Ky ze eshte paraqitur ne pasqyre duke u mbeshtetur edhe ne SKK nr 12 *Efektet e ndryshimeve te kurseve te kembimit* dhe paraqet tepricen e llogarise Arka dhe tepricen e llogarise banke, ne monedhen leke dhe euro ne date 31.12.2023. Kursi i kembimit eshte perdonur ne menyre sistematike gjate gjithe ushtrimit te aktivitetit te subjektit per ngjarjet e transaksionet te cilat jane kryer ne monedha te huaja.

2. Te drejta te arketueshme te cilat jane paraqitur ne vleren **22,428,383 leke** dhe eshte e perbere nga;

Zeri, Nga aktiviteti i shfrytëzimit ne vleren **16,291,456 leke**, i cili eshte evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr 3 ne te cilin përfshihen të gjitha të drejtat e krijuara gjate periudhes ushtrimore ndaj klientave për shitjen e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm, te paraqitura me vleren neto te realizueshme.

Zeri, Të tjera ne vleren **6,136,927 leke** perfshin te gjitha huadheniet afatshkurtra si dhe *Kerkesa ndaj tatum taksave* ku pëfshihen të gjitha të drejtat e njësisë ndaj të tretëve, te krijuar gjate periudhes ushtrimore dhe detajohet si me poshte:

Elementi	Ref	Vlera
Parapagime te dhena	418	6,136,927

3.Inventari i paraqitur ne vleren **180,826,518 leke**, i cili eshte i perbere prej;

Zeri Mallra ne vleren **142,967,819 leke** jane njojur dhe vleresuar ne perputhje me SKK nr 4 *Inventaret*. Kostoja e inventarit eshte vleresuar me metoden e kostos mesatare te ponderuar.

Blerjet e mallrave gjate vitit rezultojne ne vleren **907,386,328 leke** dhe kosto e materialeve te shitur e cila eshte pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte **870,831,977 leke**.

Zeri Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte ne vleren **0 leke**, pasqyron vleren e pote te ndertimit.

Zeri Lende e pare dhe materiale te konsumueshme ne vleren **15,291,527 leke** jane njojur dhe vleresuar ne perputhje me SKK nr 4 *Inventaret*. Kostoja e inventarit eshte vleresuar me metoden e kostos mesatare te ponderuar.

Zeri Parapagimet per inventar ne vleren **22,567,172 leke** perben parapagimet e furnitoreve per mallra dhe sherbime qe do te blihen ne periudhen e ardhshme ushtrimore.

Zeri Shpenzime të shtyra ne vleren **271,250 leke** perbehet nga shpenzime qe do te njihen ne periudhat e ardhshme.

♣ Informacione shpjeguese te AKTIVET AFATGJATA

Aktivet afatgjata jane paraqitur ne Vleren Kontabel Neto **704,190,991 leke**. Ato jane evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr.5 Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale. Paraqitia e tyre eshte bere nepermjet politikes kontabel Metoda e Kostos. Perberja e ketij zeri paraqitet si vijon;

1.Aktive afatgjata materiale jane ne vleren **698,985,384 leke** dhe eshte i perbere zeri *Toka dhe ndërtesa* ne vleren **521,770,862 leke**, zeri *Impiente dhe makineri* ne vleren **69,574,395 leke** dhe zeri *Të tjera Instalime dhe pajisje* ne vleren **107,285,120 leke**, *AAGJM te mbajtura per investim* ne vleren **355,007 leke**,

2. Aktive afatgjata jo-materiale jane ne vleren **5,205,607 leke** dhe eshte i perbere nga zeri *Koncensione, patenta, licensa, makra tregtare, te drejta dhe aktive te ngashme* ne vleren **5,205,607 leke.**

Metoda e perzgjedhur per amortizimin eshte metoda mbi vleren e mbetur dhe eshte njojur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per periudhen ushtrimore ne vleren **0 leke.**

Informacione Shpjeguese per DETYRIMET.

Detyrimet e paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **576,024,964 leke** dhe perbehet nga detyrime te periudhave afashkurtra dhe afatgjata. Detajimi jepet nepermjet informacioneve shpjeguese si vijon;

♦ Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATSHKURTRA

Detyrimet afatshkurtra jane paraqitur ne total ne vleren **396,130,487 leke**, dhe jane te perbera nga detyrimet ndaj furnitoreve, punonjesve, detyrime ndaj shtetit per tatime dhe taksa si dhe hua te tjera.

- *Detyrime ndaj institucioneve te kredise* ne vleren **3,840,842 leke** perbejne huamarrjet nga institucionet financiare afatshkurtra.
- *Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit* ne vleren **337,741,149 leke** paraqesin detyrimin ndaj furnitoreve te ndryshem te njesise ekonomike ne fund te vittit 2023.
- Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore ne vleren **32,842,746 leke** perbejne detyrimin per pagat e personelit si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetsore per muajin Dhjetor 2023 dhe detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Sigurime Shoqërore + TAP	431	7,548,825
Paga dhe shperblime	421	25,293,921

- Të pagueshme për detyrimet tatimore ne vleren **21,705,750 leke** perbejne detyrimin per muajin Dhjetor 2023 dhe detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Tatim fitimi	444	15,173,629
Tatim ne burim	447	246,399
Shteti-TVSH per tu paguar	445	6,285,722

♦ Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATGJATA

Detyrimet afatgjata jane paraqitur ne total ne vleren **179,894,477 leke** perbejne detyrimet e njesise ekonomike per huante e marra nga Institucionet e Kreditit (Bankat).

II. Informacione Shpjeguese per KAPITALIN

Kapitali i paraqitur ne vleren **331,702,090 leke** dhe eshte i perbere nga zerat Kapital i nenshkruar, Fitimet e pashperndara dhe Fitim / Humbje e vitit, detajimi i te cilave do te jepet ne informacionet shpjeguese.

1.Informacione shpjeguese te zerit KAPITAL

Ne kete ze jane paraqitur kapitali i kontribuar nga aksionerët ose nga ortakët dhe jane përbledhur tepricat kreditore të llogarive vijuese:

Emertimi	Ref	Vlera
Kapitali i paguar,	101	296,900,000

Ne perputhje me aktin e themelimit date 02 Korrik 2018 dhe vendimin per shtim kapitali nga aksioneret kapitali i kontribuar eshte i perbere nga Kuota ose aksione, gjithsej 100 pjese me vlore nominale 2,969,000 leke.

2.Informacione shpjeguese te zerit FITIME TE PASHPERNDARA

Zeri *Fitime te pashperndara* paraqitet ne vleren **14,842,128 leke** dhe perfshin fitimet që njësia ekonomike ka akumuluar nga periudhat paraardhëse.

3.Informacione shpjeguese te zerit FITIM / HUMBJE E VITIT

Zeri *Fitim / Humbje e vitit* paraqitet ne vleren **19,905,957 leke** dhe paraqitet rezultati i periudhës rrjedhese ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve pasi eshte zbritur tatimi mbi fitimin.

- ❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE.**

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve eshte paraqitur bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres. Ne kete periudhe ushtrimore ka rezultuar një fitim ne vleren **19,905,957 leke**.

Zeri Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit te paraqitura ne pasqyre evidenton te gjitha shitjet e realizuara me vleren e tyre neto **1,632,723,949 leke**.

Zeri Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme te paraqitura ne vleren **870,831,977 leke** perfaqesojne koston e mallrave te blera per qellime rishitje. Politika kontabel eshte paraqitur me larte ne zerin *Mallra per shitje* (Inventar).

Zeri Shpenzime të personelit i cili eshte i paraqitur ne vleren **346,620,253 leke** perfaqeson:

1. Shuma *Paga dhe shpërblime gjate periudhes ushtrimore 01.01-31.12.2023* ne vleren **297,253,514 leke**.

2. Shuma *Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore* (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet) gjate periudhes ushtrimore 01.01-31.12.2023 ne vleren **49,366,739 leke**.

Nga keto vlera vetem shuma **32,842,746 leke** eshte ende e papaguar e cila eshte pasqyruar ne bilanc, dhe per te cilin jane dhene informacione shpjeguese me larte.

Zeri Shpenzime të tjera shfrytëzimi te cilat jane te paraqitura ne vleren **383,593,279 leke** perfaqesojne shpenzimet te cilat jane kryer per zhvillimin e aktivitetit te njesise ekonomike, dhe perfaqeson zera te shpenzimeve si Furnitura, Taksa te ndryshme, shpenzime te tjera rrjedhese etj.

Zeri Interesa të arkëtueshëm dhe **të ardhura të tjera të ngashme** (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitet ekonomike brenda grupit) te cilat jane te paraqitura ne vleren **0 leke** perfaqesojne te ardhurat nga interesat bankare si dhe diferençat pozitive nga kurset e kembimit.

Zeri Shpenzime interesi dhe **shpenzime të ngashme** (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitet ekonomike brenda grupit) te cilat jane te paraqitura ne vleren **11,458,246 leke**, perfaqesojne shpenzimet qe vijne nga interesa bankare, interesa kredie, overdrafti etj.

Zeri Shpenzime te tjera financiare jane te paraqitura ne vleren **15,698,069 leke** dhe tregojne diferençat pozitive qe vijne nga kurset e kembimit.

Zeri Shpenzime konsumi dhe **amortizimi** jane te paraqitura ne vleren **0 leke** perben amortizimin e aseteve per vitin 2023.

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren CASH FLOW.**

Ne pasqyren e flukseve monetare jane paraqitur flukset hyrese dhe dalese te mjeteve monetare në njësine ekonomike gjatë periudhës korrente kontabël. Paraqitja eshte bere sipas metodes indirekte.

Gjate periudhes kontabel ka rezultuar;

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit ne vleren **120,428,164 leke**. Fluksi pozitiv ka ardhur pasi flukset dalese te mjeteve monetare per kryerjen e shpenzimeve si psh, paga, detyrime per kontribute te sigurimeve dhe te tatim-taksave jane me te uleta se flukset hyrese te mjeteve monetare gjate ushtrimit normal te aktivitetit nga njesia ekonomike.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit ne vleren **(85,618,161) leke** i cili ka ardhur si rezultat i pagesave per blerje te aktiveve afatgjate materiale dhe pagesave per investime ne aksione te njesive te tjera.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit ne vleren **(35,146,676) leke** i cili ka rezultuar nga marrja dhe pagesa per dividente pronareve te njesise ekonomike dhe nga pagesa e huave bankare.

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren NDRYSHIMEVE TE KAPITALIT.**

Ndryshimet ne zerin Kapital kane ardhur si rezultat;

- Fitim / Humbje e vitit ne vleren **19,905,957 leke**.

2. Rritje e kapitalit nga fitimi i mbartur ne vleren **71,800,000** leke.
3. Krijimi i Rezerva te tjera nga fitimi i mbartur **54,005** leke.

Informacionet shpjeguese per zerat e mesiperme jane dhene ne pasqyren e Bilancit.

Drejtuesi

Ervin Manushi

Hartuesi

Ersida Qamo

Ervin Manushi

[Signature]

NONA Sh.p.k.
L81904012A

[Signature]